

AKTNORMATIV
Nr.5, datë 31.12.1999

PËR PERDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE PER MBESHTETJEN
FINANCIARE TË INDUSTRISE SË KROMIT DHE TE BAKRIT

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8439, datë 29.12.1998, "Për buxhetin e shtetit për vitin 1999", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqërisë anonime "Albkrom", në buxhetin e programit të zhvillimit, të miratuar për vitin 1999, i shtohen 76,5 milionë lekë për pagesën e punonjësve të shkurtuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 17.12.1998. Ky fond përballohet në masën 24 milionë nga zëri "Konservime", të parashikuar në buxhetin e investimeve publike, të miratuar për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për vitin 1999, dhe 52,5 milionë nga llogaria e posaçme e krijuar për këtë ministri në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 20.3.1998.

2. Shoqërisë anonime "Albbakër", në buxhetin e programit të zhvillimit, të miratuar për vitin 1999, i shtohen 47 milionë lekë për përballimin e shpenzimeve për ruajtjen e objekteve të kësaj shoqërie. Ky fond përballohet në masën 12 milionë lekë nga zëri "Ndërtim-montime", të parashikuar në buxhetin e investimeve publike, të miratuar për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për vitin 1999, dhe 35 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë pas publikimit.

KRYEMINISTRI
ILIR META